

RELACION TEKNIK

Rikonstrukcion i pjesshëm dhe mobilim i dhomës së pritjes në Godinën Ekzistuese të Zyrrave të Policisë Kufitare, Porti Durrës.

Durrës

Gjendja Ekzistuese.

Ambjenti ku do të kryhen punimet ndodhet në katin përdhe të godinës ekzistuese së Policisë Kufitare në brendësi të territorit të Portit të Durrësit. Ky ambient përbehet nga një dhomë me banjë brenda saj që do të shërbeje si ambient pritje dhe akomodimi për refugjatet dhe azilkerkuesit që hyjnë në Shqipëri nga pika kufitare e portit të Durrësit. Sipërfaqja e dhomës së akomodimit është 17 m². Problematike shfaqet lageshtia në muret e dhomës së akomodimit, deri në lartësinë H=110-120 cm.

Rikonstrukcioni i pjesshëm

Për arsye të buxhetit të kufizuar dhe pamundësisë së drenazhimit të objektit në perimetrin e tij, për uljen e nivelit të lagështisë që vjen nga poshtë është menduar lyerja e mureve të dhomës së akomodimit me boje rezistente ndaj lagështires. Muret dhe tavani do të meremetohen dhe lyhen. Tualeti do të rikonstruktohet. Është ndryshuar hyrja për në tualet për të përmirësuar funksionimin e ambientit. Në tualet dyshemeja dhe muret deri në lartësinë H=210 cm do të vishen me pllakë gress porcelan (minimumi me dimensione 60x30 cm) me fuge minimale 1mm. Ngjyrat e pllakave do të jenë neutrale, mundësisht të ngrohta ose gjyrat e tokës (gri, bezhe ose kafe). Pllaka e dyshemese të zgjidhet me koeficient fërkimi kundër rreshqitjes. Dyshemeja e kabinës së dushit do të jetë me pllakë gress porcelan, me diznivel minimal dhe me kabine xhami të temperuar, që të evitohet dalja e ujit jashtë. Tualeti do të ketë dy pileta, njëra në kabinën e dushit. Tavani i tualetit do të jetë me gips. Ndriçuesët do të jenë led IP 65. Ngrohja dhe ftohja e ambientit të intervistimit do të bëhet me kondicioner 12 btu inverter me lidhje direkte.

Rifiniturat e brendeshme

Dyshemetë:

- Dyshemeja e dhomës së akomodimit do të ruhet dhe pastrohet.
- Dyshemeja e tualetit do të shtrohet me pllakë gress porcelani (min.60x30 cm), sipas përcaktimeve në projektin arkitektonik.

Muret:

- Sipërfaqja e muraturës brenda dhomës së akomodimit do të prishet në vendet e dëmtuara, risuvatohet, meremet dhe do të lyhet me bojë, sipas përcaktimeve në detajet e projektit arkitektonik dhe specifikimet teknike përkatëse.
- Sipërfaqja e muraturës në tualet do të vishet me pllakë gress porcelan deri në lartësinë H=210 cm, pjesa tjetër me suva do të patinohet dhe do të lyhet me bojë, sipas përcaktimeve në detajet e projektit arkitektonik. Veshja me pllakë më orientim horizontal.

Dyert:

- Dera e dhomës së akomodimit dhe tualetit do të jenë të reja (tamburate të rimesuara). Dera kryesore 90x210 cm (dera hyrjes në dh.akomodimit) do të jetë me

bravë sekrete. Brava e derës së tualetit të jetë me mundësinë e hapjes edhe nga jashtë. Konfigurimi dhe dimensionimi i dyerve sipas përcaktimeve në detajet e projektit arkitektonik. Shih tabelën e dyerve.

Vetratat:

- Vetrata e dhomës së akomodimit dhe tualetit do të jetë e re me duralumin termik dopio xham (tripleks 3x3 mm+6 mm)+rrjetë kundër insekteve, me ngjyre të njëjtë me vetratat ekzistuese të objektit. Konfigurimi dhe dimensionet e vetratave sipas përcaktimeve në detajet e projektit arkitektonik dhe specifikimet teknike perkatese. Xhami i vetrates së banjës do të jetë i bombarduar. Shih tabelën e dritareve.

Tavanet:

- Siperfaqja e tavanit të ambjentit në dispozicion për dhomen e akomodimit do të meremetohet, kurse e tualetit, do të vishet me gips, stukohet dhe patinohet dhe do të lyhet me bojë, sipas përcaktimeve në detajet e projektit arkitektonik dhe specifikimeve teknike perkatese.

Projekti elektrik

- Në ambjentin ku do të ketë ndërhyrje thelbësore siç është tualeti do të ribëhen instalimet elektrike. Kurse në dhomen e akomodimit mund të ketë nevojë vetëm për spostime ose përmirësim të rrjetit. Të shihet mundësia për shtimin e prizave në këte ambjent. Ndriçuesët do të jenë led IP 65. Në të gjithë ambjentet do të unifikohen kapakët, butonat dhe kutitë e prizave dhe çelsave të dritave. Shih Planin Elektrik.

Projekti ujësjes dhe kanalizime

- Në ambjentin ku do të ketë ndërhyrje thelbësore siç është tualeti do të ribëhen instalimet hidraulike. Instalimet e reja hidraulike në ambjentin e tualetit do të lidhen me rrjetin ekzistues të ujësjes dhe kanalizimeve, sipas përcaktimeve në projekt.

Rifiniturat e jashtme

Muratura e jashtme në fasaden jugore mund të ketë nevojë për meremetim dhe rilyerje për shkak të lageshtirës së krijuar. Gjithashtu për meremetim mund të ketë nevojë edhe pjesa e fasades ku do të instalohet kondicioneri.

Mobilimi

Dhoma e Akomodimit do të pajiset me 3 tavoline, 2 me dimensione 110x70 cm dhe 1 me dimensione 70x70 cm me supinë druri (mdf) dhe strukturë dhe këmbë metalike dhe në rate të veçantado të përdoret si ambient fjetje me 3 krevate teportativ me strukturë metalike, dërrasë ortopedike+dyshek (81x190xH35 cm). Në tualet pajiset hidrosanitare do të jenë të reja. Lamani do të jetë me gjysëm kollone, sospeso, pasqyra me ndriçim inkaso led me ndezje me touch dhe lidhje direkte dhe kabina dushi me xham të temperuar me hapje kendore me dimensione 80x80 cm H= 200-210 cm.

PROJEKTUESI

Ark.Genc ZAGANJORI
Nr. Liçense A-0952/1



Fig. 01 Pllaka Gress Porcelain 60x30 cm - Shembuj



Fig. 02 Kabine Dushi Kendore – Shembull



Fig. 03 Lavaman porcelani importi – Shembull



Fig. 04 ĘC porcelani importi – Shembull



Fig. 05 Krevat tek portativ str.metali,dërrasë ortopedike+dyshek (81x190xH35 cm) - Shembuj



Fig. 06 Perde Roll - Shembull